



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**  
**SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “THOMA PAPAPANO”, GJIROKASTËR**

Nr. 12/1 prot.

Gjirokastrë, më 17/01/2025

Lënda : Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE**  
**DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**  
**AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr. 15/2017 , “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të Udhëzimit nr. Nr. 759, datë 30.9.2024, “ Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit “, të Udhëzimit nr. 25, date 01/09/2023 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në Ofruesit e Arsimit Profesional”,

Shkolla e mesme profesionale “Thoma Papapano” Gjirokastrë ,ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

1. Instruktor i Praktikës Profesionale , drejtimi Sherbime ne mjete Transporti ,me kohë te plote.

**1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;

- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

**Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:**

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin profesional për të cilin po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

**2.Dokumentet e aplikimit.**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) Letërmotivimin për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (Cv-ne sipas shtojcës 11 të udhëzimit 759 dt. 30.09.2024).
- c) Kartën e identitetit;
- d) Diplomën;
- e) Librezën e punës;
- f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet ,trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;
- i) Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;
- j) Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
- l) Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
- m) Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

1. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, 27.01.2025

**DREJTOR**  
**Renata Puleri**

